



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



FTESË PËR PJESËMARRJE

TAKIM KONSULTUES ONLINE PËR RREGULLIMIN E RAPORTIMIT TË OJQ-ve

Programi për Angazhim Qytetar

Vegëza në Zoom: <https://us06web.zoom.us/meeting/register/tZUocOCvqz4pGNctg-OBjWxXqrJvjdT1FnzL>

Data: 23 shkurt, 2023

Koha: 14:00 – 15:30

Të dashur miq,

Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) në kuadër të Programit për Angazhim Qytetar në bashkëpunim me misionin e USAID në Kosovë, ju fton të merrni pjesë në takimin konsultues online për krijimin e një mekanizmi të rregullimit të raportimit për organizatat jo-qeveritare (OJQ) në Kosovë. **Takimi mbahet online më 23 shkurt 2023, nga ora 14:00 - 15:30 në këtë [vegëz](#).**

Transparenca financiare është qenësore për të rritur besimin qytetar në shoqërinë civile. Një sistem i përshtatshëm i raportimit do të duhej të bazohej në të drejtat e OJQ-ve, si dhe të jetë proporcional me madhësinë, llojin dhe veprimtarinë e organizatës përballë kërkesave të autoriteteve shtetërore.

Për ta informuar procesin konsultues, KCSF së bashku me European Center for Not-for-profit Law (ECNL) ka hartuar një analizë mbi raportimin financiar për OJQ në Kosovë. Analiza bën një krahasim të standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar dhe gjendjes aktuale në vend, si dhe ofron një pasqyrë të praktikave të pesë vendeve të BE-së. Draftin e analizës [mund ta gjeni bashkangjitur me këtë e-mail në gjuhën shqipe dhe angleze.](#)

Në këtë takim do të diskutohet mbi (1) raportimin e deritanishëm të OJQ-ve drejtë shtetit, (2) vështirësitë e hasura gjatë procesit të raportimit, (3) nevojën për klasifikim të kriterëve për raportim proporcional me madhësinë/llojin e organizatave, (4) nevojën dhe dobishmërinë e unifikimit të raportimit të OJQ-ve, si dhe (5) llojin e informatave që OJQ-të do të duhej të publikonin për të rritur transparencën e tyre.

Pjesëmarrjen mund ta konfirmoni nëpërmjet e-mailit tek rudina.hasimja@kcsfoundation.org, ose përmes telefonit në numrin 038 600 334. Ju lutem mos hezitoni të na kontaktoni për çfarëdo informate shtesë.

Ju mirëpresim në takim.



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



AGJENDA

TAKIM KONSULTUES ONLINE PËR RREGULLIMIN E RAPORTIMIT TË OJQ-ve

Programi për Angazhim Qytetar

Vegëza në zoom: <https://us06web.zoom.us/meeting/register/tZUocOCvqz4pGNctg-OBjWxXqrJvjdT1FnzL>

Data: 23 shkurt 2023
Koha: 14:00 – 15:30

14:00 – 14:05	Regjistrimi
14:05 – 14:10	Hyrje
14:10 – 14:15	Prezentimi i pjesëmarrësve
14:15 – 14:25	Prezentim i shkurtër i të gjeturave të analizës mbi raportimin financiar për OJQ
14:25 – 15:20	Diskutim i strukturuar
15:20 – 15:30	Përmbyllja
